



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2554 Prot.

Roskovec, më 01.04 2021

VENDIM

NR 21 .DATË 31.03 .2021

**“PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LISTËN E INVENTARIT, MIRATUAR ME VKM NR. 770, DATË 24.09.2010 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE ,SHTETËRORE QË TRASFEROHEN NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË BASHKISË ROSKOVEC” DHE VKB NR.48,DATË 29.06.2020 “PËR PËRDITËSIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË NDODHEN NË TERRITORIN E BASHKISË ROSKOVEC””**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, shkronja k); Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1- Të Ndryshohet :

- Në listën e Inventarit të Pronave Publike miratuar me VKM nr.770, datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Roskovec”, prona me numër rendor 133, Kanal i dytë ujitës, ujitësi i kodrave, ndryshohet nga përmasat 4000 ml në 3789 ml.
- Në listën e inventarit të pronave publike miratuar me VKB Nr.48, datë 29.06.2020 “Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme

shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Roskovec” ,prona me nr. rendor 109,me numër pasurie 340 ,ZK 3196,indeks harte 199-D, Kanal i dytë ujitës,ujitësi i kodrave ndryshohet përmasat nga 4000ml në 3789 ml.

- 2- Të shtohet në listën e inventarit të pronave publike ,prona nr. \_\_\_ me nr.pasurie 370/17,zk 3196,indeks harte 199-D,Rrugë Sekondare Roskovec,me sipërfaqe 1055 m2.
- 3- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.
- 5- Bashkëlidhur këtij vendimi :
  - Lista e Inventarit të Pronave Publike miratuar me VKM nr.770,datë 24.09.2010  
*“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Roskovec”*
  - Lista e inventarit te pronave publike miratuar me VKB Nr.48,datë 29.06.2020  
*“Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Roskovec*
  - Planvendosja
  - Formulari për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore

